



**FTESË PËR APLIKIM PËR MARRJE TË LOKALEVE ME QIRA NË RR. PERANDORI
JUSTINIAN**

Ftoheni që të aplikoni për marrje në shfrytëzim me qira të lokaleve në lagjen Pejton, nga Ndërmarrjes Publike Banesore, SH.A. Prishtinë. Pronat e poshtëshenuara lëshohen me qira.

Lokalet të cilat ipen me qira:

Llotet	Lokalet	Çmimi minimal €/m ² (pa TVSH)
Lloti I	14, 15, 16, 17, 18, 19	20
Lloti II	20, 21, 22, 23, 24, 25	21
Lloti III	1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8	19
Lloti IV	9, 10, 11, 12, 13	15
Lloti V	26, 27, 28, 29, 30, 31, 32	17
Lloti VI	33, 34, 35, 36, 37, 38	18

Përveç çmimit bazë, qiramarrësi do të paguaj TVSH-në, shërbimet e mirëmbajtjes ndaj NPB-së dhe obligimet komunale.

Periudha e Qiradhënies është për 1 vit, me mundësi vazhdimi.

Qiramarrësi është i obliguar që para nënshkrimit të kontratës me qiradhënësin, të bëjë sigurimin e kontratës së qirasë për gjashtë muaj më gjatë se vetë kontrata, në shumë prej tri qirave mujore neto.

Duke marrë parasysh që lokalet janë ndërtim i ri, me të gjitha kushtet e nevojshme për funksionim të tyre, në këto lokale janë përcaktuar kushte të veçanta, si : Nuk lejohet që në lokalin e marrë në shfrytëzim me qira të intervenohet (preket) fasada e jashtme. Mirëmbajtja e këtyre lokaleve, veçanërisht hapësirave të përbashkëta do të bëhet me kontratë të veçantë me Ndërmarrjen Publike Banesore.

Kriteret e veçanta për përzgjedhjen e aplikuesëve:

Kriteri I – Çmimi më i lartë

- 1) Çmimi më i lartë i ofruar i siguron aplikuesit maksimum 30 pikë

Kriteri II – Lloji i biznesit

- 1) Biznesi individual i siguron aplikuesit 20 pikë
- 2) Biznesi me ortakëri si dhe korporatat i siguron aplikuesit 10 pikë

Kriteri III – Bizneset me veprimtari zejtare

- 1) Biznesi zejtari (D.P.Z.) i siguron aplikuesit 25 pikë
(Nënkuptohen vetëm bizneset të cilat ushtrojnë veprimtari zejtare, jo çdo biznes i regjistruar si D.P.Z.)

Kriteri IV – Veprimtaria e biznesit

- 1) Bizneset nga fusha e gastronomisë, si: kafiteri, pastičeri, fast food e të ngjashme i sigurojnë aplikuesit 20 pikë.
- 2) Biznesi me veprimtari edukativo-arsimore si: Librari, kurse e të ngjashme i sigurojnë aplikuesit 25 pikë.
- 3) Bizneset tregtare si: butik, dyqan i kepuçave, babyshop, argjendari apo bizneset tjera tregtare i sigurojnë aplikuesit 20 pikë.
- 4) Bizneset nga fusha e IT si dhe mobil shop e të ngjashme i siguron aplikuesit 20 pikë.
- 5) Bizneset në ofrim të shërbimeve si: zyrë, barnatore, ordinancë apo të ngjashme i sigurojnë aplikuesit 20 pikë.
- 6) Bizneset nga fusha e prodhimit apo përpunimit, sigurojnë aplikuesit 25 pikë

Kriteri V – Kriteret sipas “ Rregullores për dhenien në shfrytëzim me qira të pasurive komerciale të Ndërmarrjes Publike Banesore”

1. Numri i të punësuarve nga investimi;
2. Plani i Biznesit;
3. Kohëzgjatja e veprimtarisë së biznesit;
4. Vendi i veprimtarisë së biznesit;

Poentimi sipas **Kritereve V** do të bëhet nga komisioni i Ndërmarrjes Publike Banesore gjatë shqyrtimit të aplikacioneve, dhe maksimumi i pikëve do të jetë 20.

Për ish qiramarrësit të cilët kanë qenë pagues të rregullt të qirasë u jepet përparësi për marrjen në shfrytëzim me qira, duke pasur parasysh në procesin e përzgjedhjes me 35 pikë shtesë në dallim nga aplikuesit tjerë.

Aplikuesi duhet t’i dorëzoj këto dokumente:

1. Aplikacionin për marrjen e lokaleve me qira (mund ta merrni në hapësirat e NPB-së apo në Web faqen e Ndërmarrjes Publike Banesore);
2. Kopjen e certifikatës së regjistrimit të bashkangjitur me informatat e biznesit;
3. Kopjen e certifikatës së TVSH-së nëse është deklarues i TVSH-së;

4. Kopjen e certifikatës fiskale;
5. Numrin e xhirrollogarisë bankare të biznesit;
6. Plani i Biznesit;
7. Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit të biznesit;
8. Vërtetimin që nuk është nën hetime;
9. Vërtetimin nga ATK-ja për pagesën e obligimeve tatimore;
10. Fletëpagesën për aplikim.

Sipas nevojës komisioni vlerësues mund të kërkoj dokumente shtesë.

Aplikacioni duhet të dorëzohet tek kabineti i Kryeshefit Ekzekutiv në Ndërmarrjen Publike Banesore. Zarfë duhet të jetë i mbyllur. Në zarfë (jashtë) duhet të specifikohet: emri i aplikuesit, nr. llotit për të cilin aplikohet dhe kontaktet e aplikuesit (emaili dhe nr. i telefonit).

Aplikacionet do të pranohen edhe në mënyrë elektronike përmes email: aplikimi@npbanesore.com.

Tarifa e aplikimit: 10 € (Euro). Kont: BKT 1909466981031194

Aplikacionet që nuk do të shqyrëtohen nëse:

- Aplikuesi tashmë e ka një pronë me qira nga Ndërmarrja Publike Banesore SH.A.Prishtinë;
- Aplikuesi ka pasur pronë me qira nga Ndërmarrja Publike Banesore dhe nuk i është përmbajtur kontratës së qirasë ose ka obligime të pa paguara.
- aplikohet për bizneset veprimtaria e të cilave është e ndaluar me ligj në hapësirat përkatëse;
- aplikacioni nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
- aplikacioni arrijnë pas datës së skadimit të afatit të publikimit të shpalljes.

Vlerësimi i aplikacioneve dhe përzgjedhja e përfituesve do të bëhet nga një komision i Ndërmarrjes Publike Banesore si dhe ekspert të angazhuar nga jashtë.

Afati për aplikim është i hapur nga data 04.09.2017 deri më date 18.09.2017